


BIBLIOTEKA

BSH-1  
1214



Ismail Kadareja

# K O H A

VJERSHA  
DHE  
POEMA  
**ISMAIL  
KADARE**

81H-1  
K14

i plotë

ISMAIL KADARE

Liber pëmungesa  
5.5.'94 d.

# KOH A

vjersha dhe poema



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

*Zlato*

## KOHA E POPUJVE

A II

Kur superkafshët dridhnin botën,  
Njeriu në gjunjë nuk u ul.  
 Ka pasur vite të mamuthëve,  
 Po kohë të tyre s'pati kurrë.

Me brirë të tmerrshëm e klithma kobi  
 Mbi tokë ata vunë ligjin bishë;  
 Megjithatë ish kohë e njerëzve  
 Dhe ky planet i njerëzve ish.

Nga superpesha u vinte vdekja,  
 Ngecnin përbindshat në batak.

*A III* Kështu do ngecin supershtetet  
 Në llum të globit pak nga pak.

Dhe kur në të ardhmen do zbulojnë  
 Eshtrat e tyre nëpër botë,  
 Ashtu si eshtrat mamuthore ↵.  
 Që zoologët gjejnë sot,

Kur të zbulojnë konstruktet, dhëmbët,  
Atë burokratizm-hata,  
Ç'heronj, do thonë, kanë qenë  
Popujt që rrojtën tok me ta.

Ata q'u ngritën përballë tyre,  
Që u qëndruan trimërisht,  
Ish kohë e tyre ajo, do thonë,  
Dhe ky planet i tyre ish.

*lest  
Moldavie*

## V A L L J A S H Q I P T A R E

Tri herë opinga rrahu dheun  
 Sikur kërkoi leje prej tij.  
*Rex* Pastaj shamia palët ndehu  
 Me qetësi dhe madhështi.

*Rex* } Kështu midis qiellit edhe botës  
 Vallja u lind, vallja u shpall.  
 Këmba sinjale i çon tokës  
 Dhe dora qiellit i jep lajm.

*Rex* } Dhe vallja rrokulliset tutje  
 Në kohëra hedhur si hobé.  
 Prilli përsipër i hedh lule,  
 Dhjetori borën shkund atje.

Valle shqiptare, shenja n'erë.  
 Ylbere tirqesh tej-tëhu.  
 Kush ju kërceu ju njëherë  
 Dhe këmbët rob s'i mbenë te ju.

A.2. | Kush ra midis vorbullës suaj  
Dhe s'u përzhit, dhe s'u përflak.  
Ju bubullima me opinga,  
Që nëpër shekuj bridhni varg.

## LULEMOLLËT

Lulemollët nën dritën e hënës  
Bien si brilantë diku.  
Ikin qiellit patat e egra,  
Me pak hënë në krahë gjithashtu..

Për të qenë një mbrëmje e bukur  
Pak gjëra i mjaftojnë, farc pak.  
I mjafton një shtresëz hëne,  
Si hukës së mëngjesit pak gjalpë.

Për të qenë e bukur kjo udhë  
Ritmi i hapave tonë i mjafton.  
Ja patat e egra nga krahët  
Shkundin hënën pikë-pikë si limon.

Nga dritatet e shtëpive fshatare  
Copra lajmesh të TV-së vijnë që larg.  
Për lulet e mollëve po të fliste  
Spikerja,  
s'do të çuditesha aspak.

N'Evropë jemi vendi i vetëm.  
Që në mbrëmje më parë se gjithçka  
Japim lajmet për njerëzit e thjeshtë  
Të uzinave dhe fushave të mëdha.

Mbledhin buzët me siguri ish-zotërinjtë:  
Uh, ç'lajme pa lezet, «me fshat».  
Ata që më të rëndësishëm se drithërat  
Quajnë çdo krim e psikopat.

Brilantët e Zhaklinë Onasisit  
Mbi gjitha lulet e botës vënë ata  
Dhe për rrudhat e Greta Garbos  
Psherëtijnë si për më të madhe hata.

{ Pështyj mbi sensacionet e përtej detit  
Mbi «yjtë» e «superyjtë» e gjithë c'japë *sintet*  
Të gjithë ata bashkë dinjitetin  
E një are me grurë s'e kanë.

Gjithë reklamat e tyre së bashku.  
S'kanë kaq dritë se këto lulemollë  
Lulemollët që ndershmërisht bien  
Pa kërkuar asgjë,  
nën hapat tonë.

## PARTIA IME

Atë që dot s'ma jepte kush,  
Partia ime, ti ma dhe,  
Nj'armatë shokësh sup më sup,  
Më madhështoren përmbi dhe.

Me mijra zemra që janë lidhur  
Si enë komunikuese varg.  
Në dejtë e mi me anë të tyre  
Seç rrjedh ky gjaku yt i madh.

Dhe ja, po ndjej si gjaku yt  
Me puls të njëjtë rreh në damarë,  
Që nga m'i thjeshti komunist  
E gjer te Sekretar i Parë.

Të vjetrit shpesh hyjnité i kanë  
Me shumë flatra, sy e vesh;  
Unë qesh me perënditë hindjane,  
Me perënditë greke qesh.

Me sistem zemrash lidhur bashkë,  
Që ti Partia jonë na dhe.  
M'i thjeshti komunist në radhë  
Ngrihet mbi qindra Promete.

Se s'ka më mrekulli të madhe  
Që në komunë kështu të jesh;  
Që në trup tënd gëzim e halle  
Të mijra shokëve të kesh.

Të ngjitet nga punëtori i vjetër  
Te burri i shtëtit një merak,  
Ose të zbresë nga burri i shtetit,  
Qederi i madh te bujku plak.

Dhe mua gjumi mos më marrë  
Për farën që në fushë s'mbiu.  
Për librin tim të keq fshatari  
Të kthehet njëzet herë në brinjë.

Të ndjesh Parti, si gjaku yt  
Me puls të njëjtë rrëh-në damarë  
Që nga m'i thjeshti komunist  
E gjer te Sekretar i Parë.

Unë qesh me perënditë hindjane,  
Me perënditë greke qesh.  
Me ty unë jam i lartë si malet,  
Pa ty, në çast si gogla vdes.

Me ty dhe dhembja më e thekshme,  
Ka vlerë më shumë se një gëzim.  
Me ty do t'isha i pavdekshëm  
Dhe sikur t'isha anonim.

*Abludur*

*Vespa*

## ALPET NË DHJETOR

Ç'është ky vend kështu, këto pllaja me brymë,  
 Me malet ~~sup~~ më sup e kokë më kokë përpjekur? *p*  
*person* Ja qelli ~~grt~~ i lartë, mes tij një bubullimë  
 Si ~~c~~ plagosur ikën, një shpellë të gjejë për të vdekur.

Hotelet janë larg dhe ne vazhdojmë të ikim  
 Nën borën që floknajën e saj rrëzon përqark.  
~~pop~~ Thua se kodrat ~~nudaj rogo~~,  
 Thua se brigjet ~~andogjel~~ kthejnë nga vdekja e Mujit larg.

Gjithçka është madhështore nën këtë borë bashku-  
 esc,  
 Në përzierjen e maleve dhe të njerëzve ~~ep~~,  
 Nën këtë qell të ~~madh~~ nga shkrepëtima përshkuar  
 Si nga qerre gjëmonjese tragjedish antike.

## MESUESET E FSHATIT

Ne udhekryqe, ndan' xhadeve  
Ditet e shtuna dalin shpesh  
Dhe zgjatin doren nga makinat,  
Here dy nga dy, here veç e veç.

Por shpesh ata qe jane brenda  
Me njeri-tjetrin shkembejne fraza:  
" Si shume pretendime kane,  
Mor shoku Jani keto vajza".

Dhe jane a ta qe bejne zhurme,  
Qe ka ne per vete dyzete goje,  
Qe i shkruajne leter Presidiumit  
Per nje kuzhine po t'ju mungoje.

Dhe ate presin makine tjeter,  
Atje ne rruge , atje ne shi.  
Ate, te urtat gjer ne dhembje,  
Te thjeshtat gjer ne madheshti.

Tek presin java qe kaloi  
U rikujtohet si ne tym  
Klasa me nxenesit, gabimet  
Q'u pereriten ne hartim,  
Ne mbremje ra dion degjon njera,  
Tjetres ne mend i vjen serish  
Shikimi i fotoreporterit,  
Q'andej kaloi rastesisht.

„oha e fejeses i ka ardhur,  
Dikujt dhe ndofta i shkon çdo dite  
Pluhur i shkumsit, vello e bardhe  
U bie mbi supe e i trondit.

„o s'mgrene ato boten ne kembe,  
Ne komitet , ne ministri.  
Ato te urtat gjer ne dhembje,  
Te thjeshtat gjer ne madheshti.

KOHANE BOTË

8  
synopsis

Koha është e ashpër vërtet,  
Të vrejtur janë njerëzit dhe statujat  
Nga dritaret e avionit duken  
Drama peisazhezh dhe ujërash.

Përmbi tokë qiejt e dimrit  
Mbartin kryqe dhe rrasha resh.  
K Si xhevahire të vjedhur nga vetvetja  
p Iskuqin botës qytetet e mëdhenj.

Kjo kohë secilit i bën pyetjen  
Sa të drejtë ka për qetësi,  
Ja, yll i zi, mbi shkretëtirën e Sinait,  
Syri i Moshe Dajanit rri.

Nën thundra superfuqish, si nën thundra  
Tiranozaurësh,

Orët e Kremlinit, shqota  
E dimrit të bardhë mbrapsht i ktheu.

*Mosharre bote*

K Ja po ikin, akrepët mbrapa  
Si në kalendarin e lashtë islamik.  
Moskë 1976,  
Hixhra, një mijë e treqind...

Horizontet me nofullat e bardha  
Tani shqyejnë njëri-tjetrin me gaz.  
Por orët e popujve kurrë  
S'ka forcë që t'i kthejë mbrapsht.

*se-~~de~~* Vendi im rri në kontinent  
Fener midis dallgësh, rrokopujave  
Koha është epike, vërtet,  
Epicë i don njerëzit dhe statujat.

L

\*

## MUNDJA E BALLKANASVE NGA TURQIT NË FUSHËN E KOSOVËS MË 1389

*Hris*

Fusha e mbytur në gjak e kllapi shumëgjuhëshe shtrihej

*Rosa*

tutje.

Bashkë me ditën, ballkanasit, u thyen. Medet!

Gadishulli i madh u gdhë Evropë e u ngrys Azi.

*Rosa*

Gjëma vrapon rrrafshnaltave, ikte grykave,

Ato dot nuk e mbanin, ia kthenin maleve gulçonjës,

Që e rrokullisnin pllajave, kërkonin ishuj për t'ua ndarë,

Po ishujt s'gjendeshin. Gjithçka qe bërë katrahurë.

Furtunat në qiej u hutuan, vërtiteshin si të verbra.

Plakeshin në çast vetëtimat e binin nëpër baltëra.

Qiejt po zhvisheshin. Mjerë ju, popuj të Ballkanit.

Mjerë ju gjuhështerpa, me mbaresat si shkopinj të thatë,  
me alfabete të përgjakur.

Si do t'u djegë malli për të pjellë një vjershë. Medet!

Ç'gjak do të derdhet, për të ndrequr ç'u prish këtu.



Ra nata. Një qiel i panjohur u shtrjet mbi gjithçka, i  
ftohtë,

Pastaj gjysmëhëna doli e mori në dorëzim gjithçka.

Ç'mësim i madh kjo ditë për popujt e Ballkanit.

Ç'gjak do të derdhet për të ndrequr ç'u prish këtu.

*X stepni i bëst*

## PORTReti I SKËNDERBEUT

Si ditë e plotë ai shtjellej  
 Me re dhe erë mbi atdhe.  
 Një emër, Gjergj, e kish si diellin,  
 Tjetrin si hënën, Skënderbe.

Dy brirë dhije kish mbi krye,  
 Emblemë e vjetër e çuditshme,  
 Sikur ta dintë që mes brirëvc  
 Dy perandorë do të godiste.

Njëzet e katër luftra bëri,  
 Njëzet e katër vdekje theu.  
 Ç'ka mangut linte ditën Gjergji,  
 Plotësonte natën Skënderbeu.

Pas vdekjes eshtrat iu ndanë,  
 Në mijëra varre ato u shtrinë.  
 Gjithçka të shumtë ai e pati,  
 Të vetmen kish veç Shqipërinë.

## *vezet* *lizel*

### PLAZHET NË DIMËR

Shtrirë para nesh humbëtirë e plazheve,  
Hapësirë e gjerë si në poemat e Naim Frashërit.

Plazhet të mbetur bosh pa stinën e verës  
U ngjajnë guackave që iu kanë marrë perlat.

Përbri tyre lokomotivat fishkëllejnë së largu,  
Tek tërheqin trenat plot me mollë të lagëta.

*Vlasis*

*L*

## NISJA E SHQIPTARËVE PËR NË LUFTË

U nisën për luftë, «bënë tutje»,  
Pa fjalë të mëdha e pa këngë,  
Me opingat me xhufka të kuqe  
*Si me zjarre* të vegjël mbi këmbë.

Ikën larg që të gjenin armikun.  
Çdo armik, në çdo breg, që ta gjesh.  
Ka që thjeshtë luftën e kishin,  
Sa që «tutje» e quanin thjesht.

Në çdo anë që të ecnin, patjetër  
Do t'u dilte diku midis shqotës,  
Ajo ishte për ta pjesë e jetës,  
Ish përmasa e katërt e botës.

Dhe kur binin në prille a në vjeshtra  
Nëpër brinja të shtrirë, nëpër lugje,  
Si me zjarre të vegjël të përjetshëm  
Era loste me xhufkat e kuqe.

Persa.

X

## KTHIMI I SHQIPTARËVE NGA LUFTA

Po vijnë, dil-t'i shohësh,  
Të rralluar, ja.  
Mbi opinga xhufkat  
Të përzhitura.

Ku është Cute Gjati,  
Allamani ku?  
Në rimë të një balade  
Kanë ngecur diku.

Po Marku, Dule Shkoza?  
Vonojnë pak...  
Rapsodët ecin ngadalë,  
Të verbër janë.

Ç'bëtë andej tutje,  
Ç'nam, ç'batërdi?  
Për nam s'u kujtuam,  
Bëmë Shqipëri.

Po kthehen, dil t'i shohësh  
Të rralluar me plumb,  
Khufkat mbi opinga  
Nga tymi — shkrumb.

X

## TERRORI I BARDHË

— Klasave tē pērbysura —

X

## JAVA E FUNDIT E QËNDRIMIT NË MOSKË MË 1960

Javët rrihnin ditët me ushtë,  
Nën një qiell kontinenti të murrët.  
Ulërinin të martat si bushtrat,  
Avion kishte vetëm të mërkurave.

Ditët ishin të ftohta, pa diell,  
Me një erë stepe në skajet.  
Në të mbetur në funde të dielash  
Si në funde akullnajash.

Në Moskë kishte rënë li e zezë.  
Qenë mbyllur kinematë dhe sportet,  
Koncertet, kafetë studenteske,  
Pa u mbylliën pastaj aeroportet.

Mbi pistat erë e stepës vërshëllente.  
Avionët po lageshin në shi.  
Ahëre ne e ndjemë edhe një herë,  
Pse vendi ynë quhej Shqipëri.

Diçka ne po ndjenim prej shqipeje,  
Tek supet ish një dhembje e kaltër.  
Dhe sikur karantina të vazhdonte  
Do të na dilnin, me siguri, flatrat.

# S A H A R A

## I.

Perandori e madhe e tharë,  
Dikur pjellore, plot blerim.  
Po ç'dhembje ke provuar vallë,  
Kur parandjeve shterpësinë?

Kur zvogëlohej trupi i kafshëve  
Dhe shtat i drurëve mbi dhe.  
T'u thanë në qiel<sup>l</sup> vetëtimat  
Ku Si hohokuqet në shëndré.

Njëri pas tjetrit vdisnin shirat  
Dhe iknin retë me karvane.  
Ku Si üra që pas ikjes shemben,  
Me rrapëllimë ylberet ranë.

Dhe gjithçka iku. Të braktisën  
Lumenj e zogj e flokë bore.  
E vetme mbete më në fund  
Në menopauzën madhështore.

## II.

Një natë me avion kaloja  
Mbi ty, ku hëna e vdekur ndriste,  
Shkretia jote ulëritëse  
Gjer lart, te ne në qiel ngjitej. *HJR*

Tek qeshë i humbur, tek kërkoja  
Të kapem tek diçka e gjallë,  
Këngën e Urës së Qabesë,  
Padashur buzët e mia thanë.

Si kompensim ndaj boshit, humbjes,  
Erdhi kjo këngë, çengel i jetës.  
Ajo ish kali, që më conte  
Të gjallë mes mbretërisë së vdekjes.

## III.

Kur agresionet kulturale  
Botën përshkojnë skaj më skaj,  
Ndërmend më vjen gjithmonë Sahara  
Me atë hënë sipër saj.

Dhe kënga e Urës së Qabesë,  
Që më kaloi përmes shkretimit.  
Konstruktë i saj m'i sigurt ishte  
Se urë e hekurt e Bruklinit.

Që mos dystohet arti, kombi,  
Që të mos vdesë si Sahara,  
Atje rri kënga popullore  
Si karakoll në post të parë.

8



*Emili*

## NUSET DHE DASMAT

Të veshura me mijegull

Me copëra yjsh

Nuset e krahinavc

Të Shqipërissë.

Aq të bukura dasmat

N'atë dekor të zi,

Sa që dhëndër do ndjeheshe

Njëfarësoj gjithsesi.

Si në polenin e luleve,

Që spërkat gjithçka,

Diçka nga yllësia e nuseve

Mbi supe na ra

Ti trim që rri në shkallë,  
Pse rri i menduar,  
Nëneja që të ka djalë  
S'të lë pa martuar...

Martesë shqipëtare,  
Dashuri e përgjithshme...  
Ikte vjeshta e dasmave  
Dimri i luftës vinte.

Sa shpejt nxihej ari  
Mbi stolitë e nuseve,  
Kur pas marsit të armëve  
Vinte prilli i vejusheve.

Pastaj prapë vinte vjeshta,  
Krushqit, vallet, stolitë,  
Dhe dhëndurët mes tyre  
Si meteoritë.

*Seop*,  
*X*

## POEZIA DHE TEKNIKA

Kur llozi u shpik dhe filluan të ngrenë  
Me ndihmën e llozit gjithfarë shkëmbinjsh,  
Me siguri ka dalë dikush që ka thënë:  
Erdh kohë e teknikës, poezia u prish.

Pastaj u shpikën prangat, avlëmendi,  
U gjet eklipsi i diellit ç'ish.  
Dhe kurrë s'ka munguar ai që ka thënë:  
Erdhi kohë e teknikës poezia u prish

Dhe kështu pas shpikjes së radios, telefonit,  
Kusisë me presion, makinës për mish,  
Gjithmonë do të gjendej ai që do të thoshte:  
Erdh kohë e teknikës, poezia u prish.

Dhe pasi kujtuan se kështu e vranë  
Poezinë në tokë përfundimisht,  
U nisën në kryqëzatën e tyre të marrë,  
Për ta ndjekur në plazhet e hënës si bishë

Ndërkaq pas avlëmendit dilte Homeri  
Që thurrte Iliadën, qilimin-det,  
Pas eklipseve e çikrikëve e logaritmave Aligieri  
Projektonte strukturën e skëterrës së vet.

Dhe me radhë Naimi, revolucionet, Brichti  
Qiejt i mbushnin me gjëmime stuhish,  
Ndërsa poshtë pipizanët mbanin ison e vjetor:  
Erdh kohë e teknikës, poezia u prish.

Dhe tek ulërinin se sidomos pas lidhjes  
Së TV-së me satellitet,  
                        arti krejt vdiq,

Harronin se fantazma e Bankos te Shekspiri  
Nuk ish veç reportazhi i parë televiziv.

## INTERPEJSAZH

Qiell madhështor, i ftohtë, pa kufi.  
Antena të kërrusura mbulojnë dhenë.  
Antena që mardhin e dridhen në shi,  
Që si krahë të thatë kërcënojnë hapësirat,  
Si shkopinj të verbërish trokasìn mbi çatira.  
Kudo antena. Antena. Antena.  
Nga perëndimi në lindje. Nga jugu në veri.

Mbi shekullin XX breron e fryn.  
Mbi rrafshultat e nxira, nën qiejt e lagët  
Plot emblema të vjetra, mbuluar me ndryshk,  
Shtrihen qytetet e Evropës si hidalgot.  
Vende dhe popuj të vënë nën urdhër,  
Nën dimrin e madh rresht janë strukur.  
Shtete të përdalë «me dyzet flamurë»,  
Me «sovranitet të kufizuar»  
shtete eunukë.

Bie shi mbi trojet e Paktit t'Atllantikut,  
Mbi gubernat e Traktatit të Varshavës bie shi.  
Dy ikset e shekullit XX-të natë e ditë  
Brerima e kohës i rreh me furi.  
Në netët e dimrit a s'ndjeni vallë  
Një mundim, sipër botës, një rropatje përtej,  
Dy X-t e shekullit, në dy kryqe varresh  
Supershtetet duan t'i kthejnë.

SHBA, BRSS, ç'hibrid i tmerrshëm!  
Nga kryqëzimi i tyre dolli ky SHBBRASS.  
Mbi çatinë e vjetër të botës, potershëm  
Koha rrebeschin e saj zbras.  
Por popujt midis shumë sekretesh dinë  
Dhe sekretin si varrosen perandoritë e mëdha.  
Romat, Samarkandet, Vashingtonët, Moskat  
Fituan shpesh toka, flamure, vota,  
Por shekujt kurrë s'i fituan ata.

*flor*,  
—

# X M A L L

Ca pika shiu ranë mbi qelq.  
Për ty unë befas ndjeva mall.  
Jetojmë të dy në një qytet  
Dhe rrallë shihemi, sa rrallë.

Edhe m'u duk pak e çuditshme  
Si erdh kjo vjeshtë, ky mëngjes.  
Qiejt e ngrysur pa lejlekë  
Dhe shirat pa ylberë në mes.

Dhe thënia e vjetër e Heraklitit  
Seç m'u kujtua sot për dreq:  
«Të zgjuarit janë bashkë në botë,  
Kurse të fjeturit janë veç».

Në c'ëndërr kemi rënë kaq keq,  
Që dot s'po zgjohemi ne vallë?...  
Ca pika shiu ranë mbi qelq  
Dhe unë për ty seç ndjeva mall.

## G J U H A S H Q I P E

Kur në sulm hodhën turqit  
Hordhitë e pambaruara,<sup>Wert</sup>  
Kështjellat e sintaksës  
S'i muar që s'i muar.

Në bedena poemash  
Popullore mbetën  
Kufoma divanesh e  
Kufoma bejtesh.

Kur panë se gjuhës  
S'i hodhën dot prangat,  
Lëshuan drejt saj  
Gjithfarë merimangash.

Parashtesa e pjesëza  
E lidhëza së prapthi,  
Të bukurën gjuhë  
Ta bënин lesharapi.

Në përçartje ta kthenin,  
Në delir, në jerm.  
Ishin vite të rëndë,  
Ishin shekuj plot helm.

Të të bënин ty, donin  
Shqipëri, memece.  
Po ja, erdhi Naimi,  
Si yll mbi ty ecte.

Dorën e zbetë  
Mbi ballë ta vuri,  
Të të hiqte zjarrllëkun  
Prej të sëmuri.

Dhc vdisnin pjesëzat,  
Thaheshin merimangat,  
Ndriste si perlat  
Poezia e madhe.

Kjo gjuhë, që provoi  
Akrepët e shkretëtirës,  
Çdo të thotë përçartje  
E di, oh, e di mirë.

E di ç'do të thotë  
Kllapi, hermetizëm,  
Qoftë e ardhur nga Roma,  
Qoftë nga Parisi.

Kjo gjuhë martire  
Lehonë e përjetshme,  
Që lindi mes dhembjesh  
Art të pavdekshëm.

clara

clara

# *Aliust*

## MARSHIMI I USHTRISË OSMANE NË SHQIPËRI

Marshojnë ata. Dhe sipër tyre  
Nxitojnë retë e shiut vargan  
Si gra me kovat plot që presin  
Gjakun e luftës që të lajnë.

Jakub — Uç — Tunxh — Ogllu pashai  
E komandon hordhinë e sertë.  
Mendon kronisti: ç' emër i gjatë,  
O ç' emër i gjatë mbi të shkurtrën jetë.

Në muzg provoi fatin e saj  
Ushtria në një sulm mizor.  
Dhe ranë emrat e pashait  
Me radhë si gjethet në tetor.

Mbetur në fund veç me një Uç  
Si një dru cung, ai po shihte  
Si gjaku derdhej rrëth me ngulç  
Dhe pllajave ushtria ikte.

 Si e arnuar ngjante toka  
Me plagë njerëzish e devesh.  
Dhe klithma jeniçerësh n'erë,  
Dhe nëpër natë eunukë të zes.

Gjithçka si në një makth përqarkej,  
Në baltë emblemat hedhur larg.  
Përmbysur gjysmëhënë e bakërt  
Pranë të haremët oturak.

N'agim pashai pa emër e çallmë,  
Tek vdis të fundit lutje thosh,  
Ndërsa me vete era merrte  
Ca fletë të kronikës bosh.

## MBËRRITJA E DEKRETIT PERANDORAK

Dekreti mbretëror u nis, allah.

E largët rruga gjer në Shqipëri.

Përmbi xhadetë gjysmëhëna ndrit,

Pa mbërritur mirë vullat, nisin të rrjedhin gjak.

Allah, po mbërrin dekreti perandorak!

*medetim  
shep*

## VENDET E SHKOMBËTARIZUARA

Aty këtu mbi djerrinë një shushurimë bari,  
Ca shkëmbinj me gurmazë të shqyer.

Kjo është gjithçka  
Që ka mbetur nga grahma e fundit e gjuhës.

Në hapësirë, a i sheh,  
Vijnë rrotull ca rrathë të çuditshëm ajri,  
Janë varret e valleve.

Ku janë baladat, eposi, kujtesa e kombit?  
Qimiterin e tyre mund ta gjesh,  
Aq sa të gjesh qimiterin e bubullimave.



## PURTRET MALËSORI TË HERSHËM

*classeur*

Mbi tirqet vijë e zezë  
Zbret si e zezë vetëtimë,  
Në brez armën e mbushur  
Në kokë të zbrazëtin qefin.

Kështu është shfaqur në vite  
Rrafshnaltave gjer në det.  
Në brez vdekjen e tjetrit,  
Në ballë vdekjen e vet.

*x*

Kur ndonjë ditë armiku  
Shfaqeji diku në kufi  
Kundër tij me të dyja vdekjet  
Nisej ahere ai.



## TE KËSHTJELLA E HAMLETIT NË DANIMARKË

Elsinor. Ç'akt është ky? Hyjnë turistë. Hyjmë nc.  
Sa shekuj kaluan që ty, princ Hamlet,  
T'u shfaq fantazma atje n'atë ledh,  
Të tregoi si i hodhën helm në vesh.  
Atje n'atë ledh, nën hënën e zbetë,  
Ti ngrive nga tmerri, princ Hamlet.

Veshët më dhembin  
Nga një zhurmë skëterre,  
Miliona krimë kanë dëgjuar veshët,  
Tonelata helmi në to janë derdhur,  
Propaganda fryn si erë e pareshtur.  
Vër sa të duash pambuk në veshë.

Ekranet e TV-ve janë të kaltër sonte, janë të zbetë,  
Më të zbetë se fantazma e mbretit Hamlet.  
Tregojnë ekranet për krimë të hershme,

Parathonë ekranet krimë të tmerrshme:  
Çekoslovakia u gjet e vrarë në gjumë një mëngjes.  
(Oh, helmi në vesh, ç'është helmi në vesh).  
Përpëlitet Vietnam i prerë mes për mes  
(Oh helmi në vesh, ç'është hel'mi në vesh).  
Bota plot trupa të gjymtuar shtetesh,  
Gjokse, copa të prera skaj më skaj.  
Ja antenat sipër saj si skeletë,  
Hapin krahët sikur thonë s'kemi faj.

Akoma habitesh atje mbi ledh  
Nga tregimi i fantazmës, princ Hamlet,  
Kurse unë sonte në Ruajal Hotel  
Do të flë nën një çati me një krim, me një mbret...

Perandori Hirohito në Ruajal Hotel  
(Akti i fundit. Hyjnë oborrtarë, të TV-së reporterë)  
Në veshët dhembje,  
Zhurmë e pap:erë.

Kush do ta vrasë sonte mbretin në Hotel Ruajal?  
Sonte spikerët janë të ngrysur, të zbetë,  
Ja antenat para kohe thonë «s'kemi faj».  
Propaganda fryn e shfryn pareshtur,  
Vër sa të duash pambuk në veshë.

Perandori Hirohito në Hotel Ruajal.  
Presin varg ekranet si të mpirë.  
Me thikë, me helm, me plumb? Jo, dhe jo,

Perandori mund tē bëjë harakiri.  
Do tē dridhen telat, spikerët do tē mbytin botën në  
vaj.

Ah, Hotel Ruajal, u shofsh Hotel Ruajal!

Fantazma tē tregoi pér një gotë helm, Hamlet,  
Seriozisht ti e more tregimin e saj.  
Por ç'ka bërë fantazma kur ishte mbret,  
Ç'det me helm ka derdhur, ç'oqean me vaj?...  
Ja kështjellat ngrenë pirjet skelete,  
Sikur duan tē thonë: s'kishin faj.

Nga emisionet e mbrëmshme ekranet janë tē lodhur,  
tē zbetë,  
Më tē zbetë se fantazma e mbretit Hamlet.  
Të gjithë tē vërtetën ekranet s'e thonë,  
Ashtu si fantazma në rrëfimin e saj.

Rrijnë pérpara tyre miliona Hamletër,  
Mallëkojnë, dyshojnë, shaj dhe shaj.  
Lart antenat në qiellin gri me erë  
Tundin krahët sikur thonë s'kemi faj.

Qindra vite duke ndjekur krimet e vegjël,  
Bota dot nuk e zbuloi krimin e madh,  
Po në botë ja u ngrit me mjekër gjer në retë  
Parathënësi më i madh me emrin Marks.  
Jo i hipur mbi një ledh kështjelle,  
Jo fantazmë e kaltër në gjysmëterr,

Po mbi supin gjigand të planetit  
Dyzet mijë dit e dyzet mijë net  
Dëshmon për krimin me emrin «mbivlerë»

Krim i madh, i përbindshëm me emrin «mbivlerë».  
Heshtin kore tragedish të lashtë,  
Heshtin trageditë moderne.

S'ka thikë, s'ka plumb, s'ka orë të krimit,  
S'ka sirena policie, klithma «Vrasje»,  
Veç oxhakët e uzinave të botës  
Tundin flokët kërcënueshëm mbi peisazhe.

Perandori Hirohito në Ruajal Hotel...  
Hypin, zbresin ashensorët si në katet e skëterrës...  
Fantazmë llafazane, pa zbrit nga ai ledh!  
Krimet klasore dredhin botën si rrëbesh,  
Mjaft me helmin në vesh!

---

Kopenhagen. Hotel Ruajal, 1971.

## SHPJEGIM PËR LIBRAT BESIANËS SË VOGËL

Meqë ti do diçka të grisësh patjetër  
Në bibliotekën time,

Po të shpjegoj ç'ka këtu.  
Këto libra janë shkruar gjatë shunaë e shumë  
vjetësh,  
Resht pas rreshti janë mbushur me a, i, u.

Ja për shembull ky këtu është xhaxha Homeri,  
Për gjithë ne shkrimitarët ky është babazot.  
Ku i ka sytë? Jo, s'ia ka ngrënë macja,  
Por, me sa duket, ajo ç'ka parë në botë.  
Ky mbi kalë është xhaxhi Don Kishoti, vërtet i  
marrë,  
Po më vonë jam i sigurtë se për të ti do të qash.  
Kurse këta janë xhaxhi Migjeni me Naim Frashërin,  
Që nën jastëk besoj gjithmonë do t'i mbash.  
(Sikur Zog e sulltan të mos kishte atëherë

Dhe në vend të tyre penicilinë të kishte  
Ata më shumë do të rronin dhe prej tyre së paku  
Ca ditë më të bukura në jetë ti do t'i kishe.

Por ti ngul këmbë se diçka, sidoqoftë duhet grisur,  
Në të vërtetë çdo bibliotekë për të grisur ka diçka.  
Ja këtu në qoshe rrinë grumbull ca poetë hermetikë,  
Më duket se njëfarësoj mund të merresh me ta,  
Ndërsa ti sa vete rritesh e mëson fjalë,  
Ata bëjnë të kundërtën, sa vete i harrojnë ato,  
Meqenëse tani për tani ke moshën me ta për t'u  
marrë,  
Unë hiqem mënjanë...

dhe ti vepro!

*gjergj*



## REKUIEM PËR MAJAKOVSKIN

Kam ngrënë në një tryezë me vrasësit e tij  
Në shtëpinë e pushimit të shkrimtarëve  
në Dubulti, në Jaltë.

Buzëqeshnin dhe flisnin për realizmin socialist,  
Ndërsa gjaku i tij

skuqte mbi xhamat e makinave,  
Mbi xhaketat, karriget, rrrogat e tyre,  
Mbi fytyrën kuqaloshe të Jermillovit kritik.

I binin gjoksit dhe flisnin për realizmin socialist  
Në presidiume me stof të kuq,

nën emblema me yll,  
Ndërsa atë

shtrirë gjerë e gjatë në tokën e zezë  
Dimri rus e ngrinte,  
për ta shkrirë në prill.

Forcë e errët e veshur me rrobe socialistë,  
Turmë kritikësh xhuxhë, spekulantë,

karrieristë

Sulmonin nën marshin shekullor të mediokërve:  
«Ti ishe i madh, po ne ta hëngrëm kokën».

Po ja, bronci i tij në sheshin Majakovski  
U ngrit dhe i vrenjtur vështroi vitet që vinin.  
Pas turmës së vrasësve që i njihte, ai pa  
Si retë e para të kundërrevolucionit nxinin.

*polt*,

## F Y T Y R A J O N Ě

Ku është projekti ynë,  
Ku vallë janë skicuar  
Pikëllim i mollzave,  
Hartografi e rrudhave?

Mënyrën e vështrimit,  
Mbledhjen e buzëve,  
Hap kronikat dhe gjeje  
Ditët e ultimatumeve.

Venia e pëllëmbës  
Në vesh gjatë të kënduarit,  
Nga përgjimi i alarmeve  
Është përcaktuar.

Në rrafshnaltën plot korba  
Dhe sy të vdekur,  
Lidhjen e shamsë  
Ke për të gjetur.

Të mbledhurit grusht  
Një mendim, një gojë,  
Në periferi zjarresh  
Partizanë kërkoje.

Mënyrën e ecjes,  
Shpatull më shpatull,  
Gjeje ditën e daljes  
Nga Traktati i Varshavës,

Modulimin e tipareve,  
Skicografinë e dhimbjes.  
Të gjitha kërkoi  
Në këtë dhë të lindjes.

Sido që të ndodhë,  
Kudo që të jemi,  
Te projekti i parë  
Përherë do të na gjeni.

*sheq*

## FJALIMI I ENVER HOXHËS MË 3 TETOR 1974

Fjalët e tij ikin larg, n'eter fluturojnë,  
Ku dimrat mbi pullaze shtetesh brerojnë kudo,  
Ku nën retë e mëdha monumente e kupola çohen  
Kolona me fjalë latine e hieroglife gdhendur mbi to.

Bronc e rituale parlamentesh, formula pompoze,  
Fjalë gjëmimtare përlirinë, të tingullta e të mëdha,  
Por me gjithë kupolat e jehonën solemne broncore  
Bota pavarësinë më të rrallë se uranumin e ka.

Ndaj kur një fjalë e gjallë për të  
                        çan mes sarkofagësh të vdekjes,  
Një fjalë e gjallë përlirinë,  
                        bota vë veshin në përgjim.  
Ndaj kur midis qiellit memorial të kësaj vjeshte  
Fjalët e Enver Hoxhës ndeshin,  
                        bubullimat mënjanohen me nderim.

*Volit*

## BASORELIEV

Mes vjeshtës mushkë e kuqërremtë ikte  
Krejt e pruar si n'ëndërr.

Pllanga gjaku

Si pafta bakri i tundeshin në ije,

Dhe sipër saj

përçartje e partizanit të plagosur,

Si jele flakësh që trazotëj nga era.

Mes vjeshtës mushkë e kuqërremtë ikte.

*jershirin*

20

## PUSHTIMI I ÇEKOSLLOVAKISË

Disfatistët, pasi e shajnë sa për zakon,  
Thonë: Megjithatë, i fortë është Ivani,  
Për një natë Çekinë e shtiu në dorë,  
Për një natë i doli matanë.

Kjo është një lloj si t'admirosh banditët,  
Që natën një vejushë sulmojnë në periferi,  
Se e ve ish Çekia. Udhëheqësit i kish  
Në kurbet? Në vdekje? Më keq —  
në tradhti.

Atë natë, thonë, s'punuan radarët.  
S'qenë radarët,

difikte kish ndërgjegjja e kombit.  
Praga në pranga, Praga në pranga,  
Antihimni i ri në kllapi gjëmonte.

~~K~~

## DËSHMORËVE TANË TË VARROSUR NË TOKËN JUGOSLLAVE

E dinim që ishit në veri,  
po ç'tju dërgonim vallë gjer atje?  
Letrat anembanë dheut venë,  
po s'zbresin kurrë nën dhe.

Veç sa herë që për andej  
udhëtonin retë e dimrit.  
Bashkë me ylberet, e dëborës  
diçka prej nesh jù sillnin.

Kishim për t'ju thënë shumë gjëra,  
po si t'ju gjenim gjer atje.  
Lajmet anembanë dheut venë,  
po s'zbresin kurrë nën dhe.

*Krem* 59'

## P A M J E D I M R I

Dimri mjegullat solli që larg  
Dhe karvane me re të zeza.  
Vetëtimat mbi shpinat e tyre  
Si motive përmbi velenxa.

Dhe i shkundi retë me gjithçka,  
Mbi qytetin e madh, mbi të dielën,  
Sipër vinçash, tarracash të mëdha  
E mbi salsa koncertesh, para dyerve.

Ranë reflekset e tyre, pa shih,  
N'udhëkryqe midis kalimtarëve,  
Ku veturnat shpejtonin në shi  
Për në darkën qeveritare.

Në hyrje hotelesh e kinemash  
E gëzueshme gjithçka ish matanë,  
Ndërsa lart mbi qytetin e madh  
Ecnin retë me motivet kuksjane.

## MARSHIMI I AKULLNAJËS

Unë eci përpara, rrëshqas, gjithçka përlaj:  
Shtete, gadishuj, luftra, popuj, skaj më skaj.

Uleni kokën ju kombe, erdha, jam akullnaja,  
Jam zerograda e tmerrshme, nuli, superhataja.

Jam ngjyrë e bardhë absolute, vdekje e gjithçkaje  
të ngrohtë,  
Jam ngrirje e gjakut, e zjarrit, jam memecllëku i  
botës.

Qefin që gjithçka mbështjell, shuaj, shurdhoj e vdes,  
Nën bardhësinë uniforme të lëmimit tim idiosesk.

Eci, por kohët e fundit vallë ç'po ndiej kështu?  
Mos vallë moti po <sup>ngrohet</sup>, diçka po më shkrin diku.

Diçka po më zbutet përbrenda, diçka brenda meje  
kalbet,  
Ku janë ditët e para, ditët e mia të bardha?

E ndiej që gjaku im i bardhë do mbytë dheun gjer  
në skajet,  
Do mbushen kontinente e oqeanë me pikëllim akull-  
naje.

Unë, dikur e tmerrshmja e pafundmja akullnajë,  
Ka kohë që nga parandjenja të hidhura zë e qaj.

~~shkruan~~ - ~~18~~ - ~~shef~~ - ~~shef~~

Shuef

## HËNA MBI PLEPA

~~Autograph~~  
Hëna përmbi plepa  
Pllanga - pllanga qç.  
Plepin ti e preve,  
Po hënën e lc.

~~parolekuz~~

Vajzën ti e more,  
Nuse e çove larg.  
Ajo shkoi, po žemrën  
La këtu përqark.

rit  
ndarjet

sheep

## NJU-JORKU NATËN

Nata ra mbi qytetin e bukurisë së tmerrshme,  
Ku nuk ka as lule, as zogj, as barëra...

Si zhapinj të shkathët mbi fasada u dukën  
 Veç emra dancingjesh, magazinash e baresh.

Por zhapinjtë në gjarpërinj shndërrohen më tej  
 Tek rruga 42,

tek Avenju e pestë.

Ja, sikur ka prerë damarët Broduej,  
 Mbytur në drita shumëngjyrëshe dergjet.

Grataçieleve të gjatë u merren këmbët.  
 Gotën e uiskit tund njëri si reklamë,  
 Tjetri ha çamçakiz,

një i tretë mban në dhëmbë  
 Bashkë me dramaturgun  
 titullin e një drame.

Tani rrëshqanoret — reklama atje lart  
Kafshohen e përgjaken me njëra-tjetrën.  
Xhungla,

që dikur ai shtypi nën asfalt,  
Merr hak mbi qytetin e bukurisë së tmerrshme.

albësie e  
b. borg /

## NË DITËT E VERËS

Në ditët e verës me një orkestër në skaj,  
Me tullumbace bojë portokalli  
Mund të bësh dashuri, të lahesht në plazh,  
Në ditë të tilla  
është normale.

Por në ditë të tilla mund të hapen varre  
Dhe të nxirren prej tyre idhuj.  
Prej gropave thellë mund të nxirren pamje,  
Mund të nxirren bile dhe tinguj.

Ja, në ditën me orkestër, në mbrëmjen e vonë,  
Hap gazetën dhe lexo:

Plasën

Bombat fashiste n'ambasadën tonë në Romë,  
Të bombave të dikurshme  
fantazma.

Ne që bombat e tyre të gjitha i pritëm  
Mbi supe,  
s'kanë ç'na bëjnë fantazmat.  
Megjithatë mos harro hienat-shtriga  
Në ditët me orkestër të plazhit.

lest

*lust*

## HOTELI I GJUETISË NË LEZHË

Këneta me plagët e manaferrave në skaje  
 Zgjatet në humbëtirën gri,  
 Këtu vinte shpesh konti Çiano  
 Me suitën luksoze të tij

Thonë se ndodhte që mysafirit të ftuar  
 I shtinin pas shpine në gjah.  
 Rreth e rrotull në muzg ngadalë fluturonin  
 Klithmat e viktimest «Ah!».

Gjithçka e ka mbytur harresa,  
 veç ujërat  
 Që s'kishin as gojë, as sy  
 Në formë manaferrash kanë nxjerrë anëve  
 Plagët e kuqe si dëshmi.

Lisit  
Besop

## F U S H A T D I M Ė R O R E

Fusha të mbjella me koka vezirësh e pashallarësh,  
Kontësh e kolonelësh,

era mbi to fishkëllin,

Një gjethe që fluturon,

një bisht kali,

puplat e një shpendi

Shndërrohen papritur në simbole, nishanc e grada.

Shkretimi i fushës ndolli fantazmat e vjetra,

(Sa herë ato këtu dimrin e zbritën në mes të verës).

Por gruri pas pak do të mbijë, !

Fantazmat përkohësisht do të zhduken,

Gjersa pas korreve dhe shirave të para

Të shfaqen përsëri.

Dhe përsëri do të vërtiten, duke kërkuar kokat përkatëse.

Të shqetësuara nga mosgjetja. Ku? Ku? Çfarë?

Ankthi i tyre mbi fushën dimërore do të rrrijë pezull.

18

erot

## S'MË KUJTOHET ÇFARË STINE ISHTE

S'më kujtohet çfarë stine ishte,  
S'di përse qëlloi që u ndamë,  
Di se ditët e mia pa ty ishin  
Të turbullta si në gjendje nokdauni.

Pa ty ishin lajmet e mbrëmjes, Evropa,  
Dimri mbi Azi.

Pa ty  
Stolit vjeshtor diçka i mungonte  
Dhe pishinës në periferi.

Dic̄ka i mungonte t̄e shtunës. . .  
Po bota kish mbetur po ajo.  
Po ata qenë t̄e pushkatuarit e Komunës.  
Dhe kufijtë shtetërorë po ato.

S'kish ndryshuar gjë në ligjin e mbivlerës,  
Në rrëthimin e Krujës ndryshim s'kish.  
Piramidat qenë ndërtuar po prej skllevërish  
Dhe unë isha prapë komunist.

Në përmasat reale të botës  
Të të vë unë gjeta fuqi,  
Q'andej, e largët, më vështrove  
E yllta ime, ti.

S'të harrova unë ty, por ish koha,  
Kur vetvetja harrohej sado pak.  
Ato ngjarje të mëdha që trokojnë  
Si me jele të kërleshura lart.

Ato ditë kontinentale,  
Plot me shtete në gjendje nokdauni...  
S'më kujtohet çfarë stine ishte,  
S'di përse qëlloi që u ndamë.

~~A~~ *sheol*

## NJË POEMË E PAMBARUAR PËR SHEKULLIN

Shekull XX,  
Shekull i shpejtësisë,  
Me fuqi të tmerrshme ti gjërat i vjetëron,  
S'kaluan ca vjet, për ty nisa një poemë  
Dhe erdh koha që poemës t'i bëj remont.

Kryqet mbi strofat dhe vargjet e shuara  
Duken si skelat rrötull ndërtesës në punime.  
Zhvidhos vargje dhe strofa të tëra,  
I flak  
Dhe ato bien me pluhur e rrapëllimë.

Kështu dhe ti, shekulli im,  
Botës së tërë do t'i bësh remont.  
Unë zhvidhos vargje,

Ti regjime dhe qeverira,  
Me vinçat e revolucioneve i ngre,  
Mbi gërmadhat e zeza, mbi shkatarrinat  
Me kuje i flak përgjithnjë.

Shekulli XX,  
Qeverira, ultimatumë, traktate, tension,  
Mbështjellë me rripa makinash,  
Gjyryk vigan i historisë,  
Tym e avull nxjerr,  
Vërshëllen e gjëmon.

Si një bari me katër krraba në duar  
Në horizontet e botës qëndron,  
Ti, që midis njëzet shekujsh detarë,  
Për botën do të jesh shekulli Kolomb

Dhe poema ime kështu le të mbetet  
E rrethuar me skela,  
gjithmonë në remont,  
Në pritje që ti, qindvjeçari i popujve  
Të mbarosh, siç fillove,  
me revolucion.

.....

Legende  
LAOKOONTI\*

Më shihni tek mbytem nga gjarpérinjtë  
 Në muze të Luvrit, në Madrid, në Nju-Jork  
 Para syve tuaj e aparatesh turistësh  
 Qindra vjet kam që vuaj,

nga që s'flas dot.

Si të flas? A mundet një nofull mermeri  
 Të lëvizë një grimë, të korrigjojë diçka?  
 Vini re sytë e mi, te zgavrat e thella,  
 Një enigmë si amebë të tharë atje ka.  
 ↗ h

Një të fshehtë të madhe ndrydh brenda gjoksit  
 Para syve tuaj, në Paris, në Madrid,  
 Ah, do doja gjarpérinjtë dyfish të m'i shtonit,  
 Veç sekretin e madh ta shkarkoja një ditë.  
 ↗ e

Tek më vini rrotull, unë them me vête  
 Kaq të verbër të jeni sa mos ndjeni këtë,  
 Që ky ngërç e ky ankth në gjithë qenëjen time  
 S'eshtë nga gjarpérinjtë po nga tjetër gjë?

P.R

Mijëra herë në mijëra net e ditë  
Të vërtetën e frikshme përsëris pa pushim  
Me shpresën e marrë se nga kjo përsëritje  
Ndoshta mermeri pëson një ndryshim.

Por s'ndërron ai kurrë.

Art i skulpturës

Gënjeshtrën mbi mua ka ngrirë përgjithnjë  
I mbërthyer në dëshminë e saj të rremë,  
Të vërtetën kujtoj dhe qaj për të.

Si çdo gjë e tmerrshme, éshtë i thjeshtë sekreti,  
Që brenda boshllëku i gjoksit tim mban  
Afroni, pra, kokat të dëgjoni të vërtetën,  
Mua s'më mbytën gjarpërinxjtë, po trojanët më  
vranë.

O sikur të mundja gjithçka të tregoja,  
Si do të ngrinit para meje si gur,  
Por unë jam i dënuar mës rropamës suaj  
Moskokëçarëse,   
monologun të thur.

Ju e dini se përparë Trojës aherë  
Kali i drunjjtë, dhuratë e grekërve u shfaq.  
Ky kalë në dy grupe i ndau trojanët:  
Ta pranonin atë ose ta flaknin sakaq.

Pajtim me armikun, ulërinin tradhtarët,  
Mjaft më me luftë, zjarre dhe helm.  
Erdh koha që shpatat t'i kthejmë në parmenda,  
Armiqtë në miq erdh koha t'i kthejmë.

Në mbledhje të gjata «pro» dhe «kundra» kalit  
Unë «kundrat» kryesova me tërbim. ~~me tërbim~~  
Dhe juve ju kanë thënë se ahere hyjnité  
Gjarpërinxjtë më dërguan si ndëshkim.

C'përralla kalamanjsh, ç'trillim për budallenjtë.  
Unë gjarpërinxjtë do të zbrapsja me një shqelm.  
Po ç't'i bëja fushatës së tradhtarëve kundër meje,  
Shantazheve, letrave anonime plot helm.

Ditë e natë e me javë polemika vazhdonte  
Nga shtresat e mesme gjer lart në qeveri.  
Ishte vjeshtë.

Nën qiellin e hirnosur, <sup>ep</sup> me erë  
Kali i drunjtë përjashta priste në shi.

Atë kalë unë i pari e kisha goditur,  
Ndaj, e dija këtë s'do ma falnin përjetë.  
Më në fund «vijë e butë» fitoi mbi «të ashprën»  
Dhe ne, «kokëfortët», na vunë në arrest. ~~met~~

Në burg, me gotën e ujit në mesnatë  
Helmin më dhane ata të pi,

Ata që ulërinin kundër dhunës dhe shpatës,  
Që dinin të kafshonin tamam si gjarpërinj.

Në mëngjes që pa gdhirë në breg të detit  
Ma hodhën kufomën drejt mbi zhavor.

Rapsodët aherë anembanë përhapën  
Versionin fals të gjarpërinje hyjnore *parashikoh*

Ky ishte mbarimi i polemikës për kalin.

Ju e dini me Trojën ç'ndodhi pastaj.

Tre mijë vjet rresht,

nga muzeu në muzera,

Unë hamalli i mermertë gënjeshtren mbaj.

Tre mijë vjet... Akoma zjarret e Trojës

k Si floknajë e kuqe më rrinë në sy,

Po më i tmerrshëm se zjarret, kujet e vomet;

Ishte fundi fare,

kur u bë qetësi.

Trojë e braktisur.

Hi i ftohtë  
Gërmadhë.

Dhe poshtë ne të vdekurit shtrirë

rresht.

Dhe papritur, në muzg sipër tokës së mardhur  
U ndie diçka që atë çante përmes.

Ç'ish kjo gërvimë kështu, kjo jehonë.

Vumë veshin. Kuptuam. Grekët e ligj <sup>ef</sup>

Përmbi qendrën e qytetit me parmandë lëronin,  
Për të thënë se Troja përjetë vdiq.

Ja më në fund dhe parmenda e tyre.

Ah, plugu i saj si na çante më dysh.

Nga tradhti e Trojës, nga gjithë dhembjet,  
Ky kafshimi i parmandës m'i hidhuri ish.  
*metay*

T'i kthejmë shpatat më në fund në parmenda,  
Kështu thërrisin atëherë ata.

Midis fjalëve tuaj, si mallëkim, si gjëmë  
Veshët më kapën dhe këtë hata.

Më kanë lodhur më shumë, besomëni, ca fjalë,  
Se kjo peshë e neveritshme gjarpërinjsh.  
Ju, që gjer në hënë keni shkuar, si vallë  
S'depërtoni dot gjer në gjoksin tim.

Gumëzhima juaj si zhaurimë deti *k*

Më vjen nga çdo anë, më përplaset në vesh.

Nga copëra bisedash shumëgjuhëshe rreth meje  
Shqetësimet e mëdha të botës marr vesh.

Dëgjoj emra shtetesh të rinj që kanë dalë,

Emra kombesh e popujsh të rinj dëgjoj,

Veç ai, i vjetri, i tmerrshmi kalë, *unë* <sup>ep</sup>  
Ashtu si ahere ka mbetur njëlloj.

Prej patkonjve të tij unë rrëqethem akoma  
Dhe kështu në mermer i mbrojtur siç jam, ~~inx~~  
Kurse ju, të pambrojturit, ju prej mishi dhe koske  
Vërtiteni mospërfillës nga salla në sallë.

Vërtiteni,

Fisni për teatrin e për plazhet,  
Për gjithfarë motorash e gjithfarë qeverish,  
Pa ju shkuar mendja se ai mund të shfaqet  
Në një ditë të rëndomtë, një mëngjes me shi.

Ashtu si ahore...

Po mjaft,  
u lodha.

Nga vërtitja juaj po më erren sytë.  
Nga rropama juaj veshët më gjëmojnë  
Në muze të Londrës, në Luvër e Madrit.

Në pafshi ndonjë ditë të bëhem copëra;  
Nga marazi, siç thonë, të plas, t'ia bëj «krak»,  
Jo kujtimet e Trojës, as gjarpërinjtë monstra,  
Por indiferencia juaj

do të bëhet shkak.

---

\*) Laokoonti, personalitet trojan. Legjenda thotë se ishte kundër pranimit të kalit të drunjë të grekërvë dhe si ndëshkim për këtë hyjnité progreke e mbytën me anë të gjarpërinjve. Një skulpturë e famshme e rilindjes e paraqet në çastin e mbytjes. Ka të ngjarë që vdekja ose më mirë vrasja e tij, të ketë qenë një vrasje politike, fill pas së cilës Troja rame anë të tradhtisë.

*XK*

# {SHQIPËRIA DHE TRI ROMAT}

*poemë*

I.

*first*

Dimri ç'e mbuloi  
Krejt perandorinë.  
Dyzet popuj varg  
Nën dëborë ngrijnë.

Dyzet kombe, fate,  
Gjëma të mëdha.  
Gjysmëhënë e shtetit  
Kullon dyllë mbi ta.

{ Popujt nën zgjedhë  
Janë shtrirë rrjesht.  
Lidhur këngë e zogj,  
Vënë në pranga retë.

*Yinektarhet*

Me zinxhirë ndër këmbë  
Sillen poshtë e lart  
Të fundmet ballada, *inversion*  
Dhe ca fjalë përçart.

Lidhur vjeshtrat, *dimrat*, *Ballada*  
Prillet në hapsanë.  
Popujt ç'po i ha  
Shteti i zi osman.

Lëvizin ngadalë  
Mokrat e mëdha.  
Bluajnë ngjyrat, vallet.  
Gjuhët me damblla.

Rrotullohen mokrat  
Me rënkim, me tmerr  
Dhe një miell i vdekur  
Nga ato mokra del.

## II.

Perandori turke,  
Trevë plot pikëllim.  
Pashallëqet shtrihen  
Në rresht pambarim.

Kombe tē ç'ngjyrosur  
Pa nam e nishan,  
Pa përralla, pa këngë,  
Pa një nina-nanë.

Ja, në natën pus,  
Diku shfaqet lart  
Një flamur fantazmë,  
Nj'alfabet lugat.

Vërtiten në erë  
Në një valle makth,  
Gjersa dita gdhin  
Dhe i zhduk sakaq

Perandori turke,  
Gjysmëhënë lubi, *mactaf*,  
Sa stema, flamure  
Ke gëlltitur ti.

*poem* { Alfabeti yt,  
Kope me akrepë  
Ka ngrënë me tmerr  
Dyzet alfabetë.

Dyzet alfabetë  
Faniten në terr,  
Nga gërmat e zbeta  
Gjaku çurg iu rrjedh

### III.

{ Midis dyzet popujsh  
Dhe ti, Shqipëri,  
Moj mijegulla-bardha *inom*  
Me fatin e zi.

Gjysmëhëna kosë  
Ç'ti kosit, ç'ti vdes  
Djemtë e tu të kthjellët,  
Vajzat posa vesë.

Shkon pranvera, dimri,  
Vera, vjeshta vjen,  
Po nuk kthehen djemtë  
Mbetën në Jemen.

O Jemen, Jemen, *pastri*  
O ti tokë qen!  
Atje çdo gjë shkon,  
Q'andej asgjë s'vjen.

Ç'të të nëm Jemen.  
Ti vetë nëmë je  
Do të ndjehej keq  
Vetë mallkimi atje.

O Urë e Qabesë,  
Ti dhembje me hark,

Mbetnë djemtë, mbetnë  
Përtej teje larg.

Q'andej dot s'i sjell  
Asnjë mushkë karvani,  
N'i sjelltë vec kënga,  
Iso djema mbani.

{ Ç'na i bëre djemtë,  
Jemen, o dhé turk.  
Ja po kthehen, vec  
Në köngën tabut. *fine kthoher*

Ç'kanë sjellë ashtu,  
Sikush nga tri gra,  
S'janë gra, nën-o,  
Plumba janë ata.

Ç'i përcjellin, ah,  
Plot krushq anembanë.  
S'janë krushq, nën-o,  
Sorra, korba janë.

O Jemen, Jemen,  
Emrin tënd të zi,  
Në kokë nëna lidh  
Porsi jemeni.\*)

---

\*) Jemeni — shami (nga fjala Jemen)

IV.

{ Shqipëri e sertë,  
Bar e borë e dert,  
Treqind kryengritje  
Në katërqind vjet.

*Sinektoð -*

S'të përgjunji dot  
Shtet i madh osman,  
As me shpatë e top  
Dhe as me kuran.

U përgjake ti  
Me burra, me gra,  
Me këng' e me art,  
Me veshje e gjithçka.

Shqipëri me qiejt,  
Që bën shoqëri,  
Vritesh për flamur,  
Pritesh për liri.

Flamurin me shpend  
Nuk e ke më kot.  
Shqiponjën prej tij  
Nuk ta zbresin dot.

Ky stërshteti turk  
Frikën ty ta ka.

Me të mirë të merr  
Mbreti padishah.

Eshtë i largët vendi  
Që i thonë Jemen,  
Por ka dhe më larg,  
Nga ku kurrë s'kthen.

Nuk kthen as mbi kalë,  
As përmbi baladë,  
Shekujt posi gala  
Të hanë ditë e natë.

Ç'është ky vend i zi,  
Ky i nëmur dhe?  
Janë grada e luks,  
Titujt pasha, be!

O supi i shqiptarit,  
Diagramë me vaj.  
Mbi xhoken e zezë  
Manteli i pashait.

V.

Shqipëri kush vallë  
Hallet ty ti qan?  
Duhen lotë malesh,  
Bora q'ata mbajnë.

Male me dëborë  
Qani ju në prill.  
Her' ngrihet, her' bie  
I Shqipërisë yll.

{ Seç ta thithi gjakun  
Ky shteti osman.  
Pleqëri e tij  
Rininë tënde than.

Gjaku yt i ri  
Ç'i rrjedh në damarë.  
Stërshtetit matuf  
Tetëqindvjeçar.

Veziрë, dijetarë,  
Admiralë, sa  
Ti atij i dhe,  
Po ai ç'të dha?

Të dha si këmbim  
Për gjithë ç'i dhe ti  
Një avaz të zvargur,  
Një dajre, një gri.

Arqitekt Sinani,  
Koha yj dhe re,  
Mendjen s'di ç'ta bëjë  
Ndërton minarë.

Pashallarë shqiptarë,  
Fate përmbi hon...  
Manteli i pashait  
Me xhoken lufton.

Ja Kara-Mahmuti  
Nga veriu del,  
Gjashtë herë i falur,  
Shtatë herë rebel.

S'di përse bën luftë,  
S'di inat pse ka,  
Gjashtë herë Mahmut,  
shtatë herë Kará.\*)

Si tigër në jug  
Nxin Ali Pashai,  
Nj' e çmendur furtunë  
Dhe boshllék pas saj.

Kokë e prerë e tij  
Me korrier në muzg.  
Ikën për n'Azi  
Nën një qiell pus.

---

\*) Kara (turqisht) i zi, i nxjerrë jashtë ligjit

Kështu veç e veç,  
 Ca këtu, ca atje  
 Ranë pashallëqet  
 E mëdha përdhe.

Shqipëri ç'po bën,  
 Shqipëri s'di ç'bën.  
 Gjaku, truri yt  
 Ç'po të venë dëm.

Grekërve u dhe  
 Fjalë perëndish.  
 Dritë ndan përreth,  
 Për vete mban pishë.

Tutje në Stamboll  
 Mbreti padishah  
 Duart i fërkon,  
 Shqipëri më s'kë.

O ti vend jezit,  
 Ç'të përmbysa, ha,  
 Por që larg mbi hon  
 Ndihet një dogra.

{ Vërshëllen përtej,  
Ej, një malisher!  
Me të pushkës grykë  
Vendi frymë merr.

## VII

{ I veshur me plagë  
Si me xhamadan  
Mes shekujsh duman  
Shqiptari çan.

{ Për të bërë kala  
I mjaftojnë dy gurë,  
I mjafton një shpend  
Mbi kokë si flamur.

Nën dëshminë e tij  
Bën furtunë e vdes.  
Gjaku i tij i madh  
Skuq xhoken e zezë.

O ti shpend, ti shpend,  
Që m'u ule pranë  
Mëmë e atë më pyet,  
Mëmë e atë unë s'kam.

Mengadalë, o shpend,  
Përmbi plagë m'u ul,  
Merr nga gjaku im  
shtoje mbi flamur.

### VIII

{ C'rrezëllin ashtu  
Mes shekujsh të nxirë.  
Shqiptari me plagë  
Si me xhevahirë.

Ja kronikat ruse  
Për tri Roma thonë:  
Romë e parë ish Roma,  
Romë e dytë Stambolli.

Dhe të tretën Romë  
Moskën bëjnë ata.  
Dhe Romë të katërt  
Thonë murgjit s'ka.

Ah, kronikat ruse,  
Trojckij manastir,\*)  
Seç i dhanë botës  
Një mesazh-delir.

---

\*) Manastir mesjetar rus i lidhur me carët e Kremlinit.

Me Romën e parë  
Shqipëria u ndesh.  
Për një breg u vra,  
U gri për një shesh.

Tri herë nga Evropa  
Vdekja erdh plot vaj.  
Por e bëmë copra  
Ujkonjën e saj.

Me Romën e dytë,  
Stambollin osman,  
Gjergji u përfyt  
Si xhind në tufan.

Gjysmëhëna ra  
Më në fund përdhe,  
Horizontit u ngrit  
Romë e tretë e re.

Rrafshi i Ukrainës,  
Tutje në Skithi,  
Nxori që nga stepat  
Një baloz të ri.

Shqipëri, që qiejt  
Me malet i gris,  
Përpara ç't'u ngrit  
Një zot shkurtabiq.

Nuk di me kë flet,  
S'di përpara, ç'ka,  
Shqipëri me jetë  
E vdekje të mëdha.

Vend ku pranë vesës  
Kullosin rrufe.  
Vend që rrokullis  
Perëndi përdhe.

{ Nëna që rrëth ballit,  
Kur e venë shaminë,  
Siç lidhën Jemenin,  
Lidhin Siberinë.

Kapitolit Romës  
Dhe Sulltan - Sarajt  
Ky Kremlin i Moskës  
Seç nisi t'u ngjajë.

Ulu pak sultani,  
Han - Hrushov - i dytë,  
Musolin - Sergej,  
Car - Murat - Nikitë.

Shqipëria s'pyet  
Perandor e pashë,  
Shqipëria që i thotë  
Tramundanës plaç!

## IX.

Kampin sovjetik

Dimri mbuloi krejt.

Dyzet popuj ja

Ç'janë shtrirë rresht.

Dyzet kombe, fate,

Gjëmë të mëdha.

Lart flamuri rus

Valvitet mbi ta.

Drapër i tradhtuar,

I tradhtuar çekan

Me emblema mbretësh

Të dy tani ngajnjë.

Romë e tretë ka shtrirë

Sundimin mbi ta

Rrotullohen rëndshëm

Mokrat e mëdha.

Kara - Kum, Balltik,

Mongoli, Çeki,

Bluhën kombe, gjuhë,

Himne dhe liri.

Dhe flamujt fantazmë  
Shtjellen si delir...  
Ah, profeci sllave,  
Trojckij manastir...

X.

Vetëm ti në grackë,  
Shqipëri nuk re,  
E vogla vigane,  
E moçmja e re.

Profecinë sllave  
Bëre pluhur ti,  
Ti antitriroma,  
Ti me tre liri.

E vogla vigane,  
E moçmja e re,  
Botës ndonjë shpikje  
A formulë s'i dhe.

S'shpike dot TV,  
As makinë për mish,  
S'pate kohë për to  
Ti, magje lirish

Mbrun e mbrun liri  
Dy mijë e ca vjet,  
Formulën e saj  
Nuk e mban sekret.

S'ka nevojë ajo  
Për laborator,  
Mbruhet në çdo breg,  
Në çdo mal me borë.

Ja këtë formulë,  
Që e di qysh në djep,  
Si buqetë të kuqe  
Kohës ti ia jep

Nga shkencë e lirisë  
Një mesazh të ri  
Botës ti i sjell  
Shqipja - Shqipëri!

# Smail K.

## VITET GJASHTËDHJETË

- poemë -

lust

XK

1.

Shekulli po kapërcente mesin e vet  
I kërrusur nën peshë ngjarjesh dramatike.  
Vjeshtë e vitiit 1960  
Gjethë e regjime rrëzonte tek ikte.

Vjeshtë e zakonshme tiranase.

Gumëzhinin

Nga studentët e kthyer trottaret.

Si fluturat

Vajzat e nxira në pushime plazheve

Hanin akullore,

U telefononin të lumturve.

Urbanët të mbushur me punëtorë të turneve  
Ngadalësonin ecjen te Rruga e Dibrës...  
Gjithçka ishte e zhurmshme dhe e bukur  
Në prag të festave dhe të dimrit.

Gjithçka ashtu ishte.  
Por ndërkaq në heshtje,  
Në horizont të revolucionit e të botës sonë,  
Duke dalë nga thellësitë e mjegullta të vdekjes,  
Prapë qe shfaqur një kalë troje.

Veç vinin re njerëzit n'ato mbrëmje tetori,  
Në bulevardin e madh tek ktheheshin prej shëtitjes  
Në ndërtesën masive të Komitetit Qendor  
Gjithmonë e më vonë shuheshin dritat.

Një kalë,  
Në barkun e tij mbi heshtat  
Ushtarët e motshëm s'mbështetin mjekrat.  
Ish barku i tij sa salla Gjeorgjevska ja,  
Ku Kongresi 20 përbri tundte teserat.

Ish barku i tij i tmerrshëm.

Qindra Troja  
Pregatitej të gllabëronte përmes flakësh e zisë.  
Përbri lokomotivës së hekurt të revolucioneve  
Nisi kursin troku i drunjtë i tradhtisë.

2.

Partia e Punës dha alarmin e para,  
Alarmin e kalit që u shfaq kaq pranë.  
Ata qeshën dhe vrapuan përsëri në bankete  
«Çto vy!»\*)  
me gojën plot ata thanë.

Po ne nuk qeshëm.  
Ne faktet hodhëm.  
Diçka ogurzezë faktet tregonin.  
Ashtu si në mesjetë, kur minjtë e ngordhur  
Rënien e murtajés paralajmëronin.

Lëvizjen punëtore e kërcënonte një sëmundje  
E vjetër, por e tmerrshme:  
Revizionizmi.  
Qelqet e mëdha të kohës kjo fjalë  
I çau si një krismë.

Ata e prenë të qeshurën,  
U vrenjtën,  
Ata na bënë shenjë të heshtnim.  
Kërcënimet e tyre vinin të shurdhëta,  
Si bubullimat në prag të vjeshtës.

\*) çto vy (rusisht) këtu: ç'thoni kështu

Pastaj, kur panë se heshtje s'o të kishte,  
E lanë zemërimin të derdhej.  
Duke përplasur grushtin mbi tryezën e stepave  
Ulëritën papritur:  
«Mbledhje!»

3.

Një avion fluturonte në qiellin dimëror sipër maleve,  
Drejt verilindjes. Drejt verilindjes.

Re.

Re.

Shoku Enver Hoxha mbështetur te dritarja  
Vështronte peisazhin e gjerë mbi dhe.

Shkrep i fundit i maleve u duk dhe një herë  
Nëpër mjegull

sikur dha porosinë e fundit..

Pastaj toka të huaja.

Borë. Erë.

Avioni në djep furtunash tundej. 

Ai nuk i hiqte sytë nga xhamat.

Re të zeza kudo: elektricitet, rreshje.

Horizonte të zymta.

Heshta vetëtimash,

Thyer aty-këtu si pas një përleshje.

}

Po shkonte drejt luftës.

Retë që nxinin

Në horizonte sajonin

kështjella,

llogore.

Avioni fluturonte nëpër barkun e qiellit.

Mes shkretëtirës dimërore.

4.

Në Moskë kishin rënë ngricat e para,

Mbërrinin me radhë delegatët prej gjithë botës.

Prapë sala Gjeorgjevskaia.

{ Nën llampadarët:

Reflekset e largëta të zjarreve të Trojës.

Nga muret vështronin portrete carësh,

Tryezat e vendosura në formë katërkëndëshi.

Busti i Leninit ngrihej përballë

I bardhë,

me një shikim të rëndë.

Atmosferë e nderë.

Bota e tërë

{ Mendjen atje e mbante ato ditë.

Ballë për ballë u gjendën n'atë sallë

Partitë, shtetet, tradhtitë.

Ra heshta e parë.

Salla u drodh.

Ata ulën kokat,

ata u kërrusën.

«Ç'to vy!» ata thirrën duke fshirë ballin  
E përgjakur nga ciflat e bombave t'akuzave.

Ata tundnin flokët e bardha,

tundnin mjekrat.

Ata fshinin djersët,

u binin gjokseve.

Ç'po ndodh? Si guxoni?

Në veshë gjëmonin

Kambanat e vjetra të Kremlinit të Moskës.

## 5.

Ditë të mbushura me luftë/net të dëndura me intriga,  
Trokitje në mesnatë si në tragjeditë e Shekspirit.  
N'oborr të vilës së delegacionit tonë

vetura të zeza.

Ndalojnë

Trokitje n'errësirën e ngrirë.

Trokit e zgjo. Trokit e zgjo

Me radhë.

Shfaqen në ZIM-a të zinj ata.  
Trokit e zgjo. Mikojan. Susllov.  
Torez.  
Natë e zezë,  
hata.

Presione. Premtime dinake. Shantazh.  
Kërcënime. Buzëqeshje. Shantazhe të rinj.  
Dhe ashtu siç vinin iknin nëpër natë si nëpër ankth  
Me ZIM-at e tyre të zinj.

Trokit e zgjo. Trokit e zgjo.  
Era mbi tokë  
Ngrinte dëborën dhe gjumin e vërtiste si e marrë.  
Sa të rëndë e kishe — këtë fund vjeshte, moj Moskë.  
Sa të hidhur këtë acar!

## 6.

Një avion fluturonte në qiellin dimëror ngadalë  
Drejt jugperëndimit. Drejt jugëperëndimit.

Re.

Re.  
Enver Hoxha vështronte zymtinë e maleve  
Të zbardhur nga dimri  
jashtë, atje.

Po ktheheshin. Rruga ish e gjatë. Kolltukët  
E butë dhe konfortë t'avionit herë pas here  
Zhdukeshin,  
Dhe atyre befas u dukej  
Sikur prapë çanin dëborën të zbathur si ahere.

Ai vështronte trupin e pakët t'Atdheut,  
Fshatrat, brinjët e zhveshura me erë.  
Nga u ngjit kështu si prej fundit të dheut  
Fjala e lashtë sa bota «qeder»

**Po ktheheshin.**  
Ai nuk i hiqte sytë  
Prej maleve të zbardhur që nga retë dilnin.  
Dhe nuk mendonte se në flokët e tij  
Gjithashtu ishin shtuar thinjat.

{ Dhe nuk mendonte se dhe ai do të zbardhej  
Gjithmonë e më tepër si këto bokërrima.  
S'mendonte  
Se malet e lartë gjithmonë  
Thinjen kështu  
nëpër stuhi,  
nëpër dimra.

7.

Nëpër pyllin e pafund t'antenave të hekurta  
Stuhia e propagandës frynte përmbi botë.

Kishte mbrëmje

Më shumë lajme se ajër

Thithnin mushkëritë n'atë dimër të ftohtë.

Në horizontet e ditëve të mbuluara nga retë  
Dridhej fjala gërryese «përçarje»,

Mbi halle katundesh, mbi shqetësime qytetesh  
Një mjegull e bardhë varej.

Përmes mjegullës avionët venin e vinin  
Nga pesha antenat po kërruseshin e gati sa s'binin.

Tradhti lëviz.

Tradhti ulëri.

N'aeroportin Vnukovo,

n'aeroportin Orli.

«Prerje marrëdhëniesh Shqipëri - BRSS»,

«Grindja me Kinën, prishja fatale».

Pylli i antenave gjëmonte e ulërinte

I qullur nën djersët e ftohta të ngjarjeve.

Bota nën flokë të shpupurisur radiostacionesh,

Kuaj trojanë me krahë avionesh,

Tradhti lëviz.

Tradhti ulëri.

N'aeroportin Kenedi,

n'aeroportin Orli.

8.

Çdo ciklon ka një qendër që quhet «sy».

Eshtë syri i ciklonit si syri i ciklopit

Në synë e ciklopit në ballë

të furisë

Ne u gjendëm ahere në atë dëmër të ftohtë.

Kështu ishim gjendur sa herë dikur

Përpara sultانëve të tmerrshëm turq.

{ (Mbi flamurin sovjetik kosorja e drapërit

Befas si gjysmëhënë na u duk!)

Në rrugët me shi të Tiranës, tek

xhamat

Plot avull të kafeve,

pas ndërrimit të turnit

Njerëzit bashkë me kafen pinin

Nga ekspresi i kohës lajmet e fundit.

Nga Vlora po iknin nëndetëset sovjetike

Ikte ambasadori, specialistët,

si minj.

Të gjithë po iknin, iknin, iknin,

Me Pobjedat, me Vollgat me ZIM-at e zinj.

Prapa diellit!

Kështu gjithmonë kanë ikur,

Duke menduar ardhjen, të gjithë njëlljoj.

Ylli ynë kurrë s'u shojt nga të ikurit,

Ashtu si nga të ardhurit kurrë s'u shojt.

Bllokadë

Këtë fjalë të rëndë kallkan,  
 Nga humnera e fjalëve e nxori kjo dekadë.  
 Ne që në shekuj me shumë fjalë u mësuam  
 Të tmerrshme,  
 U mësuam edhe me fjalën bllokadë.

Zona e naftës si grua shtatzënë

Dridhet nga dhembjet,  
 ngulçon gjer në re,  
 Nga uria e furrave, që është m'c rëndë se e njerëzve,  
 Tymi i uzinave u dobësua, u zbe.

Bllokadë.

Sulltanët ujët e kështjellave  
 Na e prisnin që të binim në gjunjë të këputur.  
 Kish stina kur nga toka e munduar ne s'korrnim  
 Asnjë kokërr drithë,  
 po një thes me luftë.

Kish stina kur vinte moti i lëmit,

Toka pillte jo grurë, po fantazma e mite.  
 Si e gjeje kohën midis vdekjes të lindje,  
 Tokë e përjetshme, e çuditshme!

Nga thinjat dhe rrudhat e kombit shumë herë  
Çurg rrođhi gjaku i kuq tatëpjetë  
Po kurrë s'na rrođhi kaq shumë djersë  
Si këto vite gjashtëdhjetë.

Në lagështirë minierash,  
në temperatura furrash,  
Në puse, vinça, sonda, ara  
Ne ngjiteshim,  
zbrisnim,  
pa pushim lëviznim,  
Vagonët e ditëve duke i shtyrë përpara.

Përpara.  
S'pyesnim për lodhje, për turne.  
Djersa mbi këngët na binte në dhjetor.  
Në bulevardin e madh, ndanë dallgëve të trotuareve  
Kish dritë gjer vonë Komiteti Qendror.

## 10.

Çdo ciklon, kur vjen, shkatërron e prish.  
Erozion i lëvizjes.

Përmbytje partish.  
Tradhti ulëri,  
ngulço gjer në re  
N'aeroportin Orli,  
n'aeroportin Burzhé.

Salla Gjeorgjevska,

stalla Gjeorgjevska,

Rriste kuaj tē drunjtē, tē rinj.

Herë shfaqeshin ata si avionë reaktivë,

Nerë shndërroheshin nē ZIM-a tē zinj.

Stuhi e propagandës vërshëllente si e marrë,

Partitë përqaheshin,

Mijëra dezertonin.

Kjo ishte sëmundja e rruazave tē bardha

Leuçemia e tmerrshme e revolucionit.

Kjo kohë donte nerva tē forta,

Kur dallgët politike ngriheshin sa një mal,

Kur poshtë vorbullave tē gabimeve tē vogla

Mund tē fshihej humnera e gabimit fatal.

{ Heshta vetëtimash na thyheshin mbi supç,  
Shkulmë e stuhiçë nē gjoks na godiste.

Larg,

ylbere miqsh.

Ne çanim më tutje

Midis Shillës imperialiste,

Haribdës revizioniste.

Bota nën flokë radiostacionesh

Netët e turbullta i gdhinte me zor.

Ne qëndruam nē mbrojtje tē revolucioneve

Të pamposhtur, heroikë, madhështorë.

Qëndruam.

Në bulevardin e madh,

përpara

Ndërtesës masive të Komitetit Qendror,

Mimoza përapë çlën.

Nga gjithë ky dimër

Ndër flokë vec mbeti aty-këtu ca dëborë.

## 11.

Cikloni kaloi, po bota nuk shtrohej,

Lëvizja punëtore ngrinte kokë përsëri,

Kështu ndodh gjithmonë:

Pas përmbytjes blerojnë

Pranë trungjeve të kalbur filizat e rinj.

Feneri i komunizmit n'Evropë s'u shua.

Qiellin kinez përfakte revolucioni,

Lokomotivat e revolucioneve nga treni i historisë

Tradhtarët u përpinqen më kot t'i stakonin.

Lokomotivat prapë lëvizën duke tërhequr

Me forcë titanike vitet,

dekadat.

Fishkëllima e tyre ngrihej madhështore

Mbi horizontet e mjegullta,

mbi shantazhet,

bllokadat

Të tērbuar ata vringëllinin armët.  
Atomin, nëndetëset, bakteriet, zinxhirët.  
Atje ku ZIM-at e zinj s'bënин punë,  
Avionët «Antonov» nisnin n'errësirë.

## 12.

Një avion i çuditshëm papritur u ul  
Një mesnâtë gushti n'aeroportin e Pragës.  
Rri si kokudhi në pistë.

Askush

Nuk zbret nga mysafiri i zymtë i natës.

C'është ky avion i vonuar?

Pse

Dyert nuk hapen?

C'pasagjerë do të ketë?

Brenda tij struktur mbi aparate elektronike,  
Ulisat dhe Menellajtë e shekullit të 20-ës.

Si gogol mbi Evropë fluturon Jakubovski,  
Duke zgjatur kthetrat e përgjakura nga lart.  
Përpëlitet një zog në kthetrat monstruoze,

Në kthetrat e tij

Pragë e artë.

Fluturon,

Prapa vetes lë re dhë enigmë.

Emri i tij n'orët e lajmeve tingëllon ogurzi.

E dëgjojnë pleqtë dhë pyesin nipat

Jakup pasha?

Nga doli ky pasha i ri?

### 13.

Flokët e shprishur të radiostacioneve s'ka krehër

Fishkëllejnë, <sup>hroch</sup> pleksen si gjarpërinj, <sup>t'i shtrojë.</sup> tendosen pamba-

rim.

Retë mc gjokset e grisura enden përmbi botë,

Shqipëria Traktatin e Varshavës gris me rrëmbim.

Kështu i grisëm fermanet e sulltanëve,

Pa pyetur për vulat e arta,

Për titujt e mëdhenj.

Prapë erdhë shtatori në rrugët e Tiranës

Dhe trotuarët u mbushën të zhurmshëm si përrenj.

Nga baret ku pihet në këmbë kafe ekspres,

Nga zyrat, nga korpuse uzinash e kantieresh,

Ky lajm mbi çatira qytetesh fluturoi,

Atje ku malet mbi kokë kanë crën.

Kur përbri maleve  
ngritëm të pamposhturat  
Rreshëta tuzinave:  
malet e revolucionit.

Mbi oxhaqet e tyre si mbi shkrepat e lartë  
Retë e furtunave politike grisen.  
Fluturojnë në erë puplat e trakteve  
Të ndjekura nga stuhia e madhe leniniste.

14.

Shekulli po kapërcente mesin e vet,  
I kërrusur nën peshë ngjarjesh dramatike.  
Vjeshtë e vitit 68 PUB.  
Re dhe traktate griste tek ikte.

Vjeshtë e zakonshme tiranase

Gumëzhinin

Nga studentët e kthyer trotuaret.

Si flutura

Vajza të nxira aksioneve, plazheve  
Hanin akullore,  
U telefononin të lumturve.

Urbanët të mbushur me punëtorë të turneve  
Ngadalësonin ecjen te Rrugë e Dibrës...

Kështu do të na vijnë gjithmonë vjeshtat  
Në prag të festave dhe të dimrit.

{ Këto vite të ashpër si gurë monumentesh,  
Kjo kohë,

bijë tufanesh e nënë tufanesh  
Kish brenda të ngjeshura gjith alarmet, epikën,  
Nga muret e Krujës

te zjarret partizane.

Ne bijtë dhe njëkohësisht etërit e saj  
Me të bashkë

(bashkëkohës - ç'fjalë krenare!)  
Në mijëra e mijëra radhë të panjohurish,  
Qysh tani kemi hyrë në lavdinë proletare.

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

Koha e popujve .....	3
Vallja shqiptare .....	5
Lulemollët .....	7
Partia ime .....	9
Alpet në dhjetor .....	12
Mësueset e fshatit .....	13
Koha në botë .....	15
Mundja e ballkanasve nga turqit në fushën e Kosovës më 1389 .....	17
Portreti i Skënderbeut .....	19
Plazhet në dimër .....	20
Nisja e shqiptarëve për në luftë .....	21
Kthimi i shqiptarëve nga lufta .....	23
Terrori i bardhë .....	25
Java është fundit e qëndrimit në Moskë më 1960 .....	26
Sahara .....	28
Nuset dhe dasmat .....	31
Poezia dhe teknika .....	33
Interpeisazh .....	35
Mall .....	37
Gjuha shqipe .....	38
Marshimi i ushtrisë osmane në Shqipëri .....	41
Mbërritja e dekretit perandorak .....	43
Vendet e shkombëtarizuar .....	44
Portret malësori të hershëm .....	45
Te kështjella e Hamletit në Danimarkë .....	46